



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 4.12.2020

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR
DEKRETIN NR. 11811, DATË 5.11.2020 “PËR KTHIMIN PËR RISHQYRTIM TË
LIGJIT 126/2020 “PËR METROLOGJINË”

- *Hyrje*

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32-38 dhe 86 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, shqyrtoi dekretin nr. 11811, datë 5.11.2020 “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit 126/2020 “Për metrologjinë”, në mbledhjet e tij të datës 27 nëntor dhe 2 e 4 dhjetor 2020. Mbledhjet u zhvilluan në platformën virtuale *Webex Meeting (Cisco)*.

Komisioni caktoi relator për shqyrtimin e dekretit Zotin Ilir BEQAJ.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit të projektligjit ishin përfaqësues të Institucionit të Presidentit, Z. Bledar Dervishaj dhe Znj. Katrin Treska, si dhe Ministrja e Financave dhe Ekonomisë Znj. Anila DENAJ dhe përfaqësues të tjerë të kësaj Ministrie.

- *Baza ligjore e dekretit*

Dekreti nr. 11811, datë 5.11.2020 “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit 126/2020 “Për metrologjinë”, shqyrtohet mbështetur në nenin 85 të Kushtetutës dhe nenin 86 të Rregullores së Kuvendit.

- **ARSYET PËR KTHIMIN E LIGJIT SIPAS DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

Në materialin shoqërues për arsyetimin e dekretit, Presidenti ka paraqitur sa më poshtë në formë të përmbledhur:

I. Ligji nr. 126/2020 përmes parashikimeve ligjore i hap rruga praktikave abuzive.

Ky ligj, i cili ka për objekt përmirësimin e kuadrit rregullator për veprimtaritë në metrologjinë shkencore, sistemin e njësisë së matjes, standardet e matjes, bazat për të siguruar gjurmueshmërinë e matjes, kontrollin metrologjik ligjor të instrumenteve matëse dhe rregullat për organizimin e funksionimit të sistemit kombëtar metrologjik në Republikën e Shqipërisë, në fakt, në tërësi të tij përfshin parashikime që bëjnë të mundur lehtësimin sa më shumë të procedurës që një shërbim publik që është dhe duhet të ngelet përgjegjësi e organeve publike për t'u ushtruar, të kryhet nga subjekte private, pa një procedurë të qartë dhe të mirëpërcaktuar ligjore të përgjegjësive; pa kriteret ligjore konkurrueshmërie; dhe ç'ka është akoma më e rëndë, duke mbyllur me vetëdije çdo hapësirë për kontrollin dhe monitorimin nga shteti të mënyrës se si ky shërbim publik i deleguar për t'u ofruar/ushtruar nga një subjekt privat, po realizohet në praktikë.

1. Ligji që në dispozitën e përkufizimeve, e koncepton veprimtarinë e rregullimit dhe kontrollit të sistemit të njësisë së matjes, si një veprimtari që do të duhet të kryhet nga subjektet private, vetëm duke u pajisur me një "autorizim", dhënia e të cilit mbetet në vlerësimin e Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

1.1 Ligjvënësi është kujdesur të përkufizojë termin "*Autorizim*" si një nga format e dhënies së të drejtës për të kryer verifikim të instrumenteve matëse në sferën e detyrueshme subjekteve private, vendase ose të huaja, që kryejnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë."

1.2 Ligji në tërësinë e tij e koncepton këtë lloj autorizimi për kryerjen e funksioneve me përgjegjësi shtetërore nga subjektet private, si një veprimtari që nuk jepet me koncesion, me partneritet publik privat, dhe për të cilën nuk lidhet një kontratë administrative për delegimin e ushtrimit të një shërbimi, por thjesht ushtrohet përkundrajt autorizimit!

1.3 Ndërsa një strukturë e tërë shtetërore, si Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), që duhet të kishte pikërisht për funksion dhe mision kontrollin metrologjik ligjor të instrumenteve matëse, me këtë ligj do të ketë si detyrë dhe kompetencë kryesore të sajën, autorizimin e personave juridikë privatë për verifikimin e instrumenteve matëse apo për riparimin e tyre.

1.4 Në dispozitë vijuese të ligjit, të paktën për metrologjinë ligjore, përcaktohet se kjo e drejtë ushtrohet ekskluzivisht nga subjektet private.

2. Mbikëqyrja e tregut dhe inspektimi metrologjik janë funksione shtetërore që garantojnë saktësinë e instrumenteve matës. Lënia në dorë të subjekteve private, në mënyrë të pakontrolluar, cenon direkt këtë funksion publik, i cili në mënyrë të pashmangshme do të sjell hapësira për abuzime që sjellin si pasojë dëmtimin e interesave të qytetarëve dhe të interesit publik.

2. Duke u shmangur procedura ligjore për dhënien e punës/shërbimit publik për t`u ushtruar nga një subjekt privat, gjithashtu shkelen të gjitha parashikimet kushtetuese dhe ligjore dhe që do të shkaktojnë pasoja, të tilla si:

2.1 Të mos garantohet liria e pjesëmarrjes së subjekteve private në garën për të ofruar këtë shërbim/punë publike të deleguar nga organi shtetëror.

2.2 Të cenohet rëndë dhe direkt interesi financiar shtetëror, pasi nuk përcaktohet më detyrimi për një marrëveshje me interes financiar, të lidhur me shkrim ndërmjet autoritetit publik kontraktues dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, objekti i së cilës është kryerja e punimeve, ku shpërblimi për punimet a shërbimet që duhet të kryhen/sigurohen përbëhet nga e drejta për të shfrytëzuar veprat/shërbimet që janë objekt i kontratës ose nga kjo e drejtë së bashku me pagesën.

2.3 Autorizime të tilla, pa një procedurë të përcaktuar qartë në ligj (*por që do t`i lihet një ministri në dorë ta përcaktojë*) rrezikojnë të jepen,

- në mungesë të theksuar të transparencës;

- të rrisin premisat për diskriminim të subjekteve private;

- të mungojë proporcionaliteti, efikasiteti, trajtimi i barabartë, reciprociteti dhe siguria ligjore;

kur tashmë *kriteret dhe procedurat për autorizimin e personave juridikë për (i) kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore dhe (ii) për autorizimin e personave juridikë dhe fizikë për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumenteve matëse, si dhe (iii) për monitorimin e aktivitetit/performancës së tyre*, që duhet të ishin të përcaktuara në ligj, do të normohen në nivelin e një rregulloreje të miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë.

2.4 Shmangen tërësisht parashikimet e ligjit nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar, që për dhënien e një shërbimi publik me koncesion apo partneritet publik privat, kërkojnë të paktën përgatitjen e studimeve të fizibilitetit, normojnë qartë hap pas hapi dokumentet e nevojshme dhe vetë procedurën konkurruese, fazën e negociimit të kushteve, të drejtave e detyrimeve, si dhe kriteret e vlerësimit.

2.5 Shmanget tërësisht procedura e monitorimit të ushtrimit të këtij aktiviteti.

2.6 Lihet hapësirë e gjërë për përcaktimin me subjektivizëm të tarifave të shërbimeve të ofruara nga subjekti privat, kur ky lloj shërbimi është i detyrueshëm me ligj dhe kërkon që tarifat të përcaktohen në mënyrë të tillë që të mos kthehen në kosto të tepërt për përdoruesit fundorë të shërbimit.

2.7 Nuk garantohen të drejtat e organit publik në rastet e shkeljeve të kushteve dhe kriterëve që kanë çuar në dhënien e autorizimit, apo dhe abuzimit me autorizimin, ndërkohë që nëse mes palëve do të parashikohet lidhja e kontratës administratve, shkelja e kushteve të kontratës do të çonte në penalitete për subjektin privat.

Ndërkohë që organi publik, në këtë formë të delegimit të kryerjes së shërbimeve publike përmes subjektit privat, nuk ka as edhe një mekanizëm të vetëm ligjor në dorë për të recuperuar dëmin e shkaktuar ndaj financave të shtetit dhe subjekteve të tjerë privatë dhe që mund të kërkohet në formën e dëmshpërblimit, por do të jetë vetë dhe direkt përgjegjës për mbulimin e këtij dëmi potencial.

2.8 Ligji nr. 126/2020 “Për metrologjinë”, jo vetëm bie ndesh, por shmang tërësisht detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

3. Qëllimi real i ligjit nr. 126/2020, nuk është rregullimi i sistemit të njësisë së matjes dhe kontrollit metrologjik, por privatizimi i shërbimeve të detyrueshme publike, pa asnjë kriter dhe pa asnjë kontroll.

3.1 Ndërkohë që, verifikimi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të hidrokarureve dhe gazit të lëngshëm është dhënë me koncesion, tashmë ky ligj shkon më tej, duke normuar me ligj, që ky verifikim të kryhet jo më pak se dy herë në vit. Dhe në këtë lloj shërbimi të dhënë me koncesion, përfshin përveç kontrollit, edhe sigurimin e regjimit automatik, që përfaqëson sigurimin dhe certifikimin metrologjik të tërësisë së kushteve në të cilat kryhet transferimi automatik i rezultateve të siguruara nga një instrument matës ligjërisht i kontrolluar.

Ndërkohë që, referuar Raporit të Komisionit përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, pa asnjë argumentim ligjor dhe/apo të mbështetur në të dhëna konkrete, shtimi i frekuencës së verifikimeve, rritet në mënyrë arbitrare duke përcaktuar se: *“Në varësi të analizës së riskut dhe problematikave të tregut, por në çdo rast jo më pak se 5%, periodiciteti i verifikimeve të lartpërmendura do të jetë të paktën objekt dyfishimi.”*

Ky parashikim, i kombinuar me detyrimin e përcaktuar në paragrafin 2, të nenit 22, që sanksionon se kontrolli ligjor nëpërmjet verifikimit të të gjitha instrumenteve matëse, të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm kryhet ekskluzivisht nga një person juridik privat, duket se shkon pikërisht në favor të interesave ekonomike të subjektit privat që e ka tashmë ekskluzivitetin e ushtrimit të këtij shërbimi.

Për më tepër, kur një shërbim është dhënë tashmë me koncesion, bërja taksative e detyrimit për të paktën dyfishimin e këtij periodiciteti, duket se shkon direkt në interes të subjektit privat

koncesionar dhe mund të përbëjë ndryshim thelbësor të kushteve të kontratës, që duhet të ishte shoqëruar me ndryshim të termave financiare të saj në favor të shtetit.

Pra ky ligj, kontrollin ligjor, që tashmë të paktën për instrumentët matës nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm është dhënë me koncesion, e ligjëron që në vazhdimësi, përtej çdo afati kohor, të kryhet vetëm nga një subjekt juridik privat!

4. Nëse këto kontrata përmbajnë parashikime në kundërshtim me parimet dhe procedurat e sanksionuara në ligj, tashmë ligjërohen, duke i krijuar terren dhe fitimit të të drejtave ekskluzive në ushtrimin e këtij shërbimi publik nga subjekti privat, edhe në të ardhmen.

5. Ligji nr. 126/2020, shkon në një zhbilancim total të mënyrës së kontrollit mbi veprimtaritë/shërbimet e deleguara.

5.1 Gjurmueshmëria metrologjike është cilësia e rezultatit të matjes ose vlera e etalonit të matjes, e arritur nëpërmjet një zinxhiri të pashkëputur të dokumentuar kalibrimesh, ku secili kontribuon në pasigurinë e matjeve. Dhe në këtë rast, këtë lloj matjeje të cilësisë mund ta bëjë vetëm subjekti që ka përfituar autorizimin vetë, pa kaluar filtër kontrolli, qoftë dhe periodik, nga organi publik.

5.2 Organi publik heq dorë nga monitorimi i subjektit privat që ushtron një shërbim të deleguar publik, dhe i mbyll rrugën çdo qytetari të dëmtuar nga aktiviteti i tij, të kërkojë verifikimin qoftë dhe përmes rrugës gjyqësore.

Duke përjashtuar sistemin gjyqësor dhe regjimin juridik vendas, ky ligj jo vetëm bie ndesh me nenet 4, 11, 15, 16, 17, 18, 43, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, por krijon një koracë/ombrellë mbrojtjeje ligjore për përfituesin shfrytëzues të shërbimit publik, për të mos i krijuar atij asnjë shqetësim edhe në rast se ai do të abuzojë me të drejtën e shërbimit publik që i është dhënë.

5.3 Ligji shkon edhe më tej, kur parashikon deri në mundësinë e heqjes dorë nga monitorimi i aktivitetit të subjekteve private që janë autorizuar të ushtrorjnë shërbimin publik.

5.4 Përmes këtij ligji, subjektit privat që autorizohet (*apo çdo subjekt privat që ka aktualisht një shërbim të tillë me koncesion dhe/apo ai që do ta ketë në vazhdimësi më pas*), mund të operojë i pashqetësuar nga çdo kontroll i thelluar i autoriteti shtetëror.

Ndërsa është e paqartë nëse parashikime të tilla, shkojnë në përputhje me përcaktimet e bëra në vetë kontratat e lidhura mes autoritetit kontraktues dhe koncesionarëve, kur pjesë të këtyre

kontratave janë detyrimisht dhe parashikimet për monitorimin e veprimtarisë së subjektit privat në ushtrimin e shërbimit të deleguar me kontratë.

Kushtëzimi i kryerjes së kontrollit vetëm me vendim gjykate, humbet efektivitetin e çdo lloj kontrolli të mundshëm dhe të nevojshëm, në rastet e abuzimeve të subjektit privat në ofrimin e shërbimit publik, e aq më tepër, në rastet e marrëveshjeve me subjekte të tjera private që u ofron shërbimin, në dëm direkt të interesave të konsumatorëve! Për më tepër, delegimi i ofrimit/kryerjes së shërbimeve publike nga subjekti privat, duhet të karakterizohet nga një monitorim edhe më i rreptë nga ana e institucioneve shtetërore.

II. Përcaktimet e sipërcituara dhe tepër problematike të ligjit nr. 126/2020 “Për metrologjinë” bien ndesh me parimet kushtetuese për funksionimin e tregut të lirë të parashikuara në nenin 11 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sjellin ligjërimin e konkurrencës së pandershme, vendosjen në treg të monopoleve, si dhe shkaktojnë diskriminim duke cenuar barazinë përpara ligjit.

Të gjitha parashikimet e mësipërme, çojnë në:

1. Kufizimin e lirisë ekonomike, të sanksionuar në nenin 11 të Kushtetutës
2. Cenonjnë barazinë e subjekteve para ligjit, të sanksionuar në nenin 18/1, të Kushtetutës
3. Cenonjnë sigurinë juridike, duke parashikuar që rregullat që lidhen me vlerësimin e kërkesave për autorizim për ofrimin e shërbimeve publike nga subjekte private, dhe vetë nevojën e këtij delegimi të ushtrimit të funksionit publik nga privati, të përcaktohen mbi bazën e një akti të nxjerrë nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe financat, dhe jo të jenë përcaktuara në ligj. Duke shmangur kësisoj edhe zbatimin e legjislacionit në fuqi që normon dhënien e punëve/shërbimeve publike për ndjekje/ofrim nga subjektet private.
4. Dëmtojnë konsumatorin dhe nuk ofrojnë garanci për mbrojtjen e interesave të tij.
5. Cenonjnë buxhetin e shtetit, duke qënë se ligji nuk parashikon asnjë rregullim për mënyrën e negocimit apo përcaktimit të tarifave për subjektin privat të autorizuar apo për marrësit e shërbimit të detyruar, dhe nuk shoqërohet me ndonjë analizë për koston e transferimit/delegimit të këtij shërbimi publik pranë privatit.

III. SHQYRTIMI I ARSYEVE TË KTHIMIT TË LIGJIT

Z. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Institucionit të Presidentit, prezantoi në mënyrë të përmbledhur arsyet që Presidenti ka vlerësuar për të kthyer për rishqyrtim në Kuvend ligjin nr. 126/2020 “Për metrologjinë”.

I. Komisioni, u njoh me sqarimet e Ministres së Financave dhe Ekonomisë, Znj. Denaj në lidhje me pretendimet e dekretit për kthimin e këtij ligji për rishqyrtim.

Konkretisht, Znj. Denaj sqaroi deputetët se:

Ligji i ri i metrologjisë është një ligj, i cili ka nisur në vazhden e një përshtatshmërie të shumë akteve juridike, të cilat, duke shkuar drejt nevojës për përshtatshmërinë e ligjeve me direktivat europiane, krijojnë rregulla më të mira dhe më të qarta për të gjithë aktorët në përgjegjshmëri të rregullave të një ligji, për të cilin bëhet fjalë. Ky është një ligj i nisur për të përshtatur të gjithë fushën e veprimtarisë së metrologjisë dhe të veprimtarisë së DPM-së, Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, brenda direktivës europiane.

Ligji i ri ka në fokus një element shumë të rëndësishëm, vendosjen në konsideratë të të gjithë faktorëve realë, aktualë në sektorin e metrologjisë, përfshirë edhe vendosjen e disa funksioneve të dhëna me ligj një koncesionari, por jo të gjitha. DPM-ja, në bazë të ligjit, ka në funksion kontrollin ligjor të instrumenteve matës ligjërish të kontrolluar në treg, ku aktualisht janë 50 mijë instrumente matës ligjërish të kontrolluara që kryejnë verifikime në fushat e matjes, gjatësisë, volumit dhe presionit.

Element shumë i rëndësishëm ka të bëjë me nevojën për sqarim të të gjitha produkteve që janë për të vendosur të gjithë operatorët për atë që është duke ardhur dhe është ndarja shumë e qartë e atyre që janë regjim automatik për matjen e vëllimit, volumetrisë, dhe regjimit automatik për fiskalizimin. Regjimi automatik i matjes së vëllimit është ai që sot po diskutojmë, dhe regjimi automatik fiskal nuk i takon këtij ligji.

Ligji nuk krijon asnjë situatë paragjyquese apo preferenciale dhe në asnjë rast nuk parashikon ndonjë dispozitë për shmangien e konkurrencës për ushtrimin e shërbimit publik. Ky ligj parashikon standarde më të larta për vënien në përdorim të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara. Konkretisht, për sa u përket instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, vënies së tyre në treg, përdorimit të këtyre instrumenteve matëse, detyrimeve të përdoruesve të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara në përdorim, parashikohen në nenin 17 e në vijim të këtij ligji, për të garantuar me standardin më të lartë shërbimin publik metrologjik.

Detajimi dhe plotësimi i mëtejshëm i këtyre rregullimeve ka kryekëput një ndryshim, nuk është më me rregulla që përcaktohen nga një drejtor i përgjithshëm, siç e kemi sot, por sipas propozimit të ministrit përgjegjës për Ekonominë kalon për diskutim dhe për vendim në Këshillin e Ministrave. Pra, kemi bërë një hap cilësor pikërisht me këtë ligj, për ta kaluar nga një vendim i një drejtori të përgjithshëm, që është sot, në një vendim ku ministri dhe Këshilli i Ministrave e analizojnë dhe shqyrtojnë të gjithë këtë çështje.

Për pretendimin e Presidentit që rregulli i përgjithshëm që përcakton ligji është ai i autorizimit të subjekteve private pa asnjë përkufizim ligjor në kritere, kushte apo procedura të detyrueshme që

duhen ndjekur, Znj. Denaj sqaroi se ligji nuk shmang në asnjë dispozitë rolin dhe kompetencën e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

DPM-ja do të kryejë shërbimin në momentin kur ka një ankesë, dhe jo vetëm DPM-ja, sepse ka edhe institute të tjera, si ISHMT-ja. Sipas fushës së veprimtarisë, në varësi të një ankese që mund të vijë nga çdo subjekt, dhe në rastin e një koncensionari ose ushtrimi veprimtarie të koncensionarit, sigurisht, kontrollat nga institucionet si ISHMT-ja dhe DPM-ja janë kontrolle të rutinës së veprimtarisë së tyre, që burojnë nga ligjet respektive të tyre, dhe në rast se do të ketë një pretendim me vendim gjykatë për kontrollin laboratorik, këtë nuk e përjashton ky ligj, pra do të vazhdojnë të njëjtat rregulla, të cilat janë fuqi.

Ligji është pjesë e një direktive europiane ose e nevojës për të përshtatur me direktivat e BE-së, dhe sjell përmirësime, jo përkeqësime.

II. Gjithashtu, në përgjigje të interesit të Komisionit, Znj. Denaj, ka sqaruar në lidhje me arsyetimet e Presidentit për kthimin e ligjit 126/2020, me anë të shkresës së tyre Prot. 22061/2 Dt. 1.12.2020 sa më poshtë:

Në lidhje me arsyen 1, 1.1 dhe 1,2 të dekretit të Presidentit të Republikës sqarohet se: Autorizimin si procedurë nuk e ka përcaktuar ligji nr. 126/2020 “Për metrologjinë”, por ka qenë tek ligji nr. 9875, datë 14 .02.2008 “Për Metrologjinë”, i ndryshuar dhe edhe në këtë ligj nuk ndryshon formën e tij.

Autorizimi si procedurë përcaktohet në ligjin nr. 9875, date 14 .02.2008 “Për Metrologjinë” që në përkufizimet e këtij ligji dhe konkretisht në nenin 3, pika 20. Edhe në ligjin e ri 126/2020 në nenin 3 pika 24 nuk ka ndryshime të këtij përkufizimi, pra është i njëjti përkufizimi për *Autorizimin*.

Për sa i takon procedurave ligjore në lidhje me Autorizimet, ato përcaktohen me ligjin “Për Metrologjinë”, nr. 9875, datë 14 .02.2008 i ndryshuar, në nenin 40 pika 2. Gjithashtu, edhe në ligjin e ri nr. 126/2020 “Për metrologjinë”, në nenin 39 pika 2, e tij. Pra, nuk ka ndryshime thelbësore te nenit përveç ndarjes kur ka forma të tjera ligjore.

Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë është anëtare me të drejta të plota e organizatave ndërkombëtare si OIML dhe çdo dispozitë rregulluese e parashikuar në procedurat e ligjit nr.126/2020 nga ky institucion i referohet këtyre organizmave dhe direktivave në fuqi

Ligji i ri për metrologjinë, ashtu si dhe ai në fuqi 9875/2008 nuk pengon asnjë subjekt privat apo të huaj që plotëson kriteret të jetë pjesë e tregut për shërbimin e caktuar. Ligji për metrologjinë i vitit 2008 dhe ligji i ri i metrologjisë i vitit 2020 si dhe rregullorja ekzistuese nuk vendosin nene

kufizuese mbi asnjë subjekt, por parashikojnë dispozita konkurrenciale për subjektet mbi shërbimet, të cilat jepen me autorizim nga DPM.

Ligji i metrologjisë i vitit 2008 dhe ai i vitit 2020 nuk kanë parashikuar përjashtimin e këtij shërbimi nga dhënia me koncesion ose forma të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, siç është forma e partneritetit publik privat, dhe si e tillë nuk shmanget asnjë procedurë ligjore për lidhjen e ndonjë kontrate bazuar në rregullat e koncesionit apo partneritetit publik privat apo nuk shmanget parimi i konkurrencës dhe përzgjedhjes për lidhjen e ndonjë kontratë koncesioni ose partneriteti publik privat e shërbimeve publike. Nga ana tjetër, ligji 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar në nenin 5 parashikon rastet e përjashtimit të koncesioneve dhe partneritetit publik privat. Në këtë nen nuk parashikohet që fusha e shërbimit të metrologjisë të përjashtohet nga procedurat konkurruese për dhënie me koncesion ose partneritet publik privat.

Në ligjin e ri për metrologjinë nr. 126/2020, sikundër edhe në ligjin e vitit 2008, nuk ka asnjë dispozitë që të kufizojë apo përjashtojë rolin e institucioneve përgjegjëse shtetërore nga kjo detyrë funksionale, të cilën sikundër në shumë ligje sektoriale shteti mund ta ushtrojë vetë përmes institucionit shtetëror përkatës, përmes subjekteve të autorizuar apo të licencuara apo përmes dhënies së këtij shërbimi përmes një kontrate koncesioni ose partneriteti publik privat të shërbimeve publike.

Përzgjedhja e mënyrës për kryerjen e këtij shërbimi i nështrohet një analize financiare, teknike dhe ekonomike leverdisshmërie, ku në çdo rast do të përzgjidhet mënyra që është më efektive, më e favorshme për shtetin dhe që garanton parimet e tregut të lirë dhe konkurrueshmërisë. Kjo procedurë zbatohet jo vetëm në Shqipëri por edhe në vendet e Evropës dhe ato të Ballkanit.

Në lidhje me arsyetimin 1.3 të dekretit të Presidentit të Republikës sqarohet se: DPM-ja ka në strukturën saj organizative Drejtorinë e Metrologjisë Ligjore e cila në bazë të ligjit ka në funksion kontrollin ligjor të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar në treg. Aktualisht janë rreth 50 000 instrumente matës ligjërisht të kontrolluar të cilave u kryen verifikime përkatësisht, në fushat e masës, gjatësisë, volumit, presionit etj.

Numri aktiv i autorizimeve është 15, dhënë gjatë viteve nga 2008 dhe në vazhdim në fushat e energjisë, ujit, cisternat rrugore, riparim tek peshoret.

Për sa më sipër, nenet e përcaktuara në ligj janë të qarta se çfarë përgjegjësie ka DPM-ja ku autorizimi zë një % të vogël në raport me detyrat e tjera ligjore. Nga shifrat dhe të dhënat zyrtare përcaktohen se cila është detyra më e rëndësishme e DPM-së.

Ligji për metrologjinë nr. 126/2020 nuk krijon asnjë situatë paragjyquese apo preferenciale, si dhe në asnjë rast nuk parashikon ndonjë dispozitë për shmangjen e konkurrencës për ushtrimin e shërbimit publik. Ky ligj parashikon standardet më të larta për vënien në përdorim të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara.

Për sa i përket instrumentave matëse ligjërish të kontrolluara, vënies në treg të tyre, përdorimit të këtyre instrumentave matës, detyrimeve të përdoruesve të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara në përdorim, llojet dhe kategoritë e verifikimeve të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, vendin dhe shenjimin e tyre, certifikimin dhe verifikimet e tyre, parashikohen në nenin 17 e vijues të këtij ligji, duke parashikuar një institut të plotë ligjor për të garantuar me standardin më të lartë shërbimin publik metrologjik. Dejatimi dhe plotësimi i mëtejshëm i këtyre rregullimeve ligjore do të bëhet me vendime të Këshillit të Ministrave dhe udhëzime të ministrit përgjegjës për metrologjinë.

Në çdo rast kryerja dhe matja e performancës së tyre nuk është e pa mbuluar, por sipas këtij ligji dhe ligjeve të tjera në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu, për rastet kur këtë funksion nuk e ushton DPM-ja, por një subjekt i autorizuar, ligji i koncesionit 125/2013, i ndryshuar dhe vendimi nr. 575., datë 10.7.2013 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar, parashikojnë dhe garantojnë rregullat dhe procedurat e detyrueshme që ndiqen mbi konkurencshmërinë dhe transparencën publike të përzgjedhjes së operatorit ekonomik që përmbush kushtet dhe kriteret në rastin e dhënies me koncesion të këtij shërbimi me lidhjen e një kontrate koncesioni ose partneriteti publik privat. Si rrjedhojë, pretendimi i presidentit për vakum të kriterëve ligjore apo kushteve për zbatim në rastet përjashtimore, nuk qëndron.

Në lidhje me arsyen 1.4 shkresa sqaron se, nuk përbën rast për ekskluzivitet të një shërbimi nga një subjekt privat dhe që të përjashtojë funksionet e DPM-së. Nëse ligji do ta konsideronte rast përjashtimor nga funksionet e DPM-së, kjo do të ishte nga ana e teknikës legjislative në një nen të veçantë dhe do të ndiqte parimin e përjashtimit të këtij funksioni nga funksionet e tjera të DPM-së në nenin 8 të ligjit. Kur ky shërbim ushtohet nga një person i autorizuar me një nga format ligjore në fuqi, atëherë DPM-ja nuk e verifikon këtë shërbim të verifikimit të instrumentave matës, sepse është pikërisht ky subjekt i autorizuar që ka marrë përgjegjësinë ligjore për ta ushtruar këtë detyrë mbi bazën e një procedure të qartë ligjore dhe detyrimeve kontraktuale, ku pjesë është edhe monitorimi i zbatimit të kontratës së shërbimit.

Në çdo rast, si DPM-ja, ashtu edhe subjekti privat i autorizuar duhet të informojnë inspektoratin dhe/ose autoritetet e tjera shtetërore kur konstatohen paligjshmëri për shërbimin e instrumenteve matëse, pra në asnjë rast nuk delegohet ky funksion publik te subjektet private dhe asesi të prodhojë cënimin e interesit publik.

Në lidhje me procedurën e autorizimit e dhënë nga DPM-ja, janë përcaktuar procedura ligjore dhe nënligjore të qarta. *Tregu* në çdo rast është i hapur për çdo aplikim nga çdo subjekt, i huaj apo vendas, nuk ka kufizim për aplikim apo miratim për ato shërbime të cilat janë të përcaktuara sipas nenit 39, pika 2 e ligjit 126/2020. Në asnjë dispozitë nuk parashikohen raste të shmangies nga konkurrimi apo dhënien e autorizimeve për këta subjekte pa plotësuar kriteret e parashikuara.

Në rast se shërbimin e kryen DPM-ja, atëherë zbatohen parashikimet e ligjit të metrologjisë dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Në rast se do të aplikohet ligji për koncesionet partneritetin publik privat, atëherë do të zbatohen rregullat konkurruese që parashikon ky ligj për një kontratë publike.

Në lidhje me pretendimin e Presidentit për vendosjen e tarifave, sqarohet se: Aktualisht, tarifat e shërbimit për çdo verifikim të çdo aparati/instrumenti matës të shpërndarjes së karburantit apo gazit të lëngshëm aplikohen sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë dhe Ministrit të Financave nr.2, datë 08.02.2013, udhëzimit të përbashkët midis ministrit përgjegjës për ekonominë dhe energjinë nr. 5346, datë 20.10.2016 “Udhëzimi mbi përcaktimin e tarifave tavan të shërbimit të verifikimit të mjeteve matëse të energjisë elektrike”, si dhe udhëzimit të ministrit përgjegjës për ekonominë, nr. 3078, datë 18.04.2016 “Për miratimin e tarifave tavan që do të përdorin personat juridik dhe fizikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, si dhe labororet e etaloneve kombëtare, jashtë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë”, që janë aktet nënligjore të cilat përcaktojnë qartë rregullat dhe funksionim nga ana financiare të subjekteve të autorizuar.

Mënyra dhe funksionimi financiar në dhënien e shërbimit të palëve të treta është kryer sipas praktikave më të mira ndërkombëtare të propozuara nga DPM, duke patur një metodologji nga ana e tyre të përlllogaritjes së tarifave dhe analiza të kostove me shërbimin e ofruar.

Në lidhje me arsyetimin nr.2.3 të dekretit të Presidentit sqarohet se: Autorizimi i dhënë nga DPM-ja ka procedura të qarta ligjore, duke u mbështetur në rregullat e politikave të organizatave ndërkombëtare dhe direktivave dhe vendeve të Evropës dhe rajonit, duke e lënë tregun të hapur duke mos diskriminuar asnjë subjekt i cili kërkon dhe konkurren të operojë në treg nëse plotëson të gjitha kriteret ligjore të përcaktuara. Në asnjë nen të ligjit të ri nr.126/2020 “Për Metrologjinë”, por edhe atij të vitit 2008, nuk përcaktohet që ministri jep autorizime, por miraton procedurën përkatëse.

Në lidhje me monitorimin e performancës aktualisht detyrimet janë të përcaktuara në ligj dhe konkretisht në urdhrin e ministrit nr. 3078., datë 18.04.2016, ku në pikën 11 të tij është përcaktuar përbërja e grupit të monitorimit, kërkesat dhe kriteret përkatëse.

Në lidhje me arsyetimin nr.2.4 dhe 2.5 të dekretit të Presidentit sqarohet se: Ligji i ri për metrologjinë nr. 126/2020 nuk jep shërbime me koncesion sipas ligjit të përcaktuar nr. 125/2013, të sipërcituar. Jemi në fazën e autorizimit ku DMP-ja , në mungese të kapacitetit teknik, jep autorizim për shërbim dhe jo në dhënien e koncesioneve dhe partneriteteve publike private. Në asnjë pikë të ligjit për metrologjinë DPM-ja nuk merr atributet e një autoriteti kontraktor për dhënien me koncesion të një shërbimi sipas ligjit të sipërcituar.

Në lidhje me arsyetimin nr.2.6 të dekretit të Presidentit sqarohet se: Aktualisht, tarifat e shërbimit për çdo verifikim të çdo aparati/instrumenti matës të shpërndarjes së karburantit apo gazit të lëngshëm aplikohen sipas bazës ligjore të cituar në shpjegimet e mësipërme. Në asnjë rast tarifat e shërbimit nuk i vendos subjekti privat, por sipas ligjit, janë kompetencë e ministrive përgjegjëse, sikundër kanë qenë në fuqi deri tani.

Në lidhje me arsyetimin nr.2.7 të dekretit të Presidentit sqarohet se: Në varësi të shkeljeve të konstatuara në treg apo nga monitorimi i subjekteve të autorizuar në varësi të dëmit që ka shkaktuar, ndërmerren veprimet ligjore administrative dhe gjyqërore për adresimin e pasojave juridike nga këto shkelje.

Në lidhje me arsyetimin nr.2.8 të dekretit të Presidentit sqarohet se: Neni 39/1 i ligjit 126/2020 “Për metrologjinë” parashikon se: “Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë jep autorizimin në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij, dhe për aq sa lejohet dhe mundësohet nga ligje, kontrata koncesionare dhe instrumente të tjera që kanë forcën zbatuese të ligjit.” Pra, është e qartë se këto autorizime jepen duke respektuar parashikimet e ligjeve të tjera dhe rrjedhimisht edhe parashikimet kumulative të nenit 26 të ligjit 90/2012. Ligji për metrologjisë nr.126/2020 sipas nenit 39, pika 2, autorizon subjektet për kryerjen e shërbimeve për të cilat DPM-ja nuk ka kapacitete teknike për ta kryer shërbimin. Për këtë rrjedhimisht ndër të tjera, duhet të plotësohen të gjitha pikat e nenit 26 të ligjit nr. 90/2012. Për pasojë komenti i Presidentit për shkelje të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” nuk qëndron. Baza ligjore dhe nënligjore që parashikon ligji 126/2020 nuk krijon boshllëk ligjor apo shmangie të përgjegjësisë së subjekteve të autorizuar.

Në lidhje me arsyetimin nr.3.1 të dekretit të Presidentit sqarohet se: Urdhri i Ministrisë nr. 194, datë 09.03.2009 përcakton rregullat mbi verifikimin fillestar dhe pasardhës të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, përcakton në pjesën 2 aneksi 2.1 frekuencën e instrumenteve të sistemit të matjes së lëngjeve përveç ujit. Ky periodicitet është përcaktuar nga kushtet konkrete të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar të instaluar në treg në fushat përkatëse. Periodiciteti i instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar të naftës dhe gazit kryhet dy herë në vit. Verifikimi i këtyre instrumenteve është i përcaktuar që në vitin 2009. Ky periodicitet është reflektuar në ligj.

Sa i përket regjimi automatik, sqarohet se përcaktohet që në përkufizimin e ligjit, dhe konkretisht neni , pika 34, : *”Regjimi automatik”, përfaqëson sigurimin dhe certifikimin metrologjik të tërësisë së kushteve, në të cilat kryhet transferimi automatik i rezultateve të siguruara nga një instrument matës ligjërish i kontrolluar.*”_Regjimi automatik bën transmetimin e transaksioneve që kryhen nga instrumenti matës. Në ligjin 126/2020 nuk parashikohet në asnjë nen që ky të jetë shërbim që mund të ofrohet nga persona juridik që mund të jepet me një forme tjetër të parashikuar në ligj. Regjimi automatik nuk cilësohet si një shërbim dhe nuk parashikohet të ketë tarifë, pasi tarifat përcaktohen me udhëzim ministri dhe janë parashikuar vetëm për instrumente matës ligjërish të kontrolluar.

Personat juridikë të cilët ofrojnë shërbime të verifikimit të instrumenteve matës ligjërish të kontrolluar në fushën e hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm që kanë marrë miratim tipi dhe plotësojnë kërkesat teknike dhe metrologjike referuar kësaj dispozite të ligjit, nuk mund të kryejnë verifikim të instrumenteve ligjërish të kontrolluar në përdorim nëse ato nuk janë në regjim automatik. Kjo garanton që përdoruesit e instrumenteve nuk janë duke kryer evazion fiskal.

Në lidhje me arsyetimin nr. 3.3, 3.4 dhe 4 të dekretit të Presidentit sqarohet se: Ligji 126/2020 në asnjë nen të tij nuk jep apo përcakton rregulla dhe procedura për dhënien me koncesion ose partneritet publik privat të shërbimeve metrologjike. Ky ligj parashikon regjimin kur ky shërbim nuk ofrohet nga DPM-ja po nga një subjekt tjetër i përcaktuar sipas legjislationit në fuqi (dhënien me koncesion). Pretendimet e ngritura gjejnë referim në çdo rast te studimi i fizibilitetit dhe dokumentet e tenderit të koncesionit të cilat nëse procedura rezulton e suksesshme konkludon me miratimin e kontratës së koncesionit. Të gjitha këto hallka mbi analizën e tregut, risqet fiskale dhe leverdisshmërinë e shtetit shqiptar për dhënien me koncesion janë të parashikuara te këto dokumenta bazuar në legjislationin në fuqi për koncesionet dhe partneritetin publik privat.

Në asnjë praktikë evropiane, institutet e metrologjisë nuk kryejnë riparim të instrumenteve matës ligjërish të kontrolluar. Për pasojë, shmangia e një praktike të tillë sjell një konflikt të hapur interesi, sipas parimit që ai që kryen riparimin e instrumenteve matës nuk mund ta verifikojë atë.

Në lidhje me pretendimin se ligji 126/2020 ligjeron shkeljet e munshme të kontratave të dhëna me koncesion, sqarohet se: Ligji i metrologjisë nr.126/2020 në asnjë moment në nenet e tij nuk ligjeron asnjë kontratë koncesioni apo të fiksojë vetëm një formë juridike për shërbimin e verifikimit të instrumenteve matës të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm. Në këtë nen kjo është një ndër format ligjore të parashikuara për kryerjen e këtij shërbimi. Në çdo rast përzgjedhja e formës së kryerjes së shërbimit bëhet në zbatim të legjislationit përkatës në varësi të llojit të procedurës së ndjekur nga institucioni shtetëror.

Në lidhje me arsyetimin nr.5,5.1 dhe 5.2 të dekretit të Presidentit sqarohet se: Gjurmueshmëri janë të gjitha hallkat e zinxhirit të verifikimit të rezultateve të matjes që kryhen nëpërmjet etalonëve dhe laboratorëve e cila dokumentohet. Dhënia e shërbimit të verifikimit të hidrokarbureve me një formë tjetër ligjore e ka kaluar gjurmueshmërinë metrologjike tek ky subjekt, pasi nuk mund të bëhet ndërprerje e zinxhirit të verifikimit. Nëse do të ishte parashikuar ndryshe nuk do të ishte efektive procedura e verifikimit dhe nuk mund të sigurohet një transmetim i saktë të njësisive matëse. Në këtë nen parashikohen vetëm rastet e jashtëzakonshme kur rezultoni e nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për shërbimet, objekt i këtij ligji. Për të shmangur konfliktin e interesit i është lënë gjykatës në marrjen e vendimit për vazhdimin e procedurës. Vendosja e ekspertizës ndërkombëtare me laboratorë të akredituar vetëm ka rritur nivelin e sigurisë për shërbimin të cilin subjektet në format e tjera të parashikuara ligjore ofrojnë sot në treg.

Në lidhje me arsyetimin nr. 5.3 të dekretit të Presidentit sqarohet se: Ligji 126/2020 nuk parashikon heqjen dorë të funksionit të monitorimit, sepse parashikon që nëse shërbimi është dhënë me një nga format e tjera ligjore ose kontratë është ligji apo kontrata përkatëse që parashikon kushtet dhe menyrën e monitorimit. Në çdo rast, këto parashikime ligjore ose kontraktuale detajojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe mbikëqyrjen e subjekteve të autorizuar, raportimin periodik të tyre dhe rastet e adresimit të problematikave.

Ligji nuk heq dorë nga ushtrimi i përgjegjësive monitoruese, sepse edhe në format e tjera ligjore apo kontratë është përsëri institucioni shtetëror që miraton ligjin apo nënshkruan kontratën me subjektin privat.

Ligji i miratuar ose kontrata e nënshkruar nga autoriteti shtetëror përgjegjës dhe subjekti privat bazohet mbi studimin e fizibilitetit dhe projektin e detajuar, dokumentet e tenderit, dokumente të cilat përfshijnë të gjithë analizën teknike, financiare, ganancitë juridike dhe teknike për kryerjen e shërbimit duke parashikuar edhe risqet dhe certifikatat e cilësisë për kryerjen e shërbimit nga ana e subjekt të përzgjedhur nga konkurimi publik. Puna në terren e subjektit të autorizuar bazohet mbi raportimet periodike, si dhe kontrollet e parashikuara nga Autoriteti Kontraktor përgjegjës për zbatimin e detyrimeve kontraktuale. Monitorimi i shërbimit të dhënë me koncesion parashikohet në kontratën mes palëve.

Në lidhje me arsyetimin nr. 5.4 të dekretit të Presidentit sqarohet se: Aktualisht inspektimi metrologjik përfshin ekzaminim fizik, dokumentar dhe laboratorik i cili kryhet nga ISHMT-ja në bazë të ligjit për inspektimin dhe ligjit për metrologjinë nr. 9875, date 14.02.2008. Me anë të kontratës të koncesionit mbi shërbimi i verifikimit të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar kryhet tashmë nga koncesionari. Në ligjin nr.126/2020 është parashikuar që inspektimi metrologjik mund të përfshijë dhe ekzaminim laboratorik si funksion e tij vetëm me

vendim gjykate. Nëse sot kryejmë një ekzaminim laboratorik dhe instrumenti del jashtë gabimeve maksimale të lejuara atëherë ISHMT-ja merr mase bllokimi dhe kthimin në konformitet të instrumentit. Në këtë moment përdoruesi i instrumentit i cili e ka verifikuar këtë instrument pranë trupës së akredituar (në këtë rast koncesionari) i lind e drejta që të kërkojë të drejtën e tij pasi është duke u përballur me kosto shtesë për një shërbim verifikimi të cilin e ka kryer nga trupa e akredituar (në këtë rast koncesionari). Në një mosmarrëveshje të tillë, palët ISHMT-ja dhe trupa e akredituar (në këtë rast koncesionari) do t'i drejtohen gjykatës për një zgjidhje për ekzaminim laboratorik.

Për sa më sipër, në rast se ISHMT-ja konstaton nëpërmjet ekzaminimit laboratorik të lejuar nga gjykata se instrumenti është jashtë gabimeve maksimale të lejuar, përdoruesi i këtij instrumenti përballlet me kostot e rikalibrimit dhe rivefikimit jashtë rradhe nga trupa e akredituar (koncesionari). Në këtë rast përdoruesi i instrumentit ka të drejtën që t'i kërkojë ta zgjidhë problematikën trupa e akredituar, në këtë rast koncesionari.

Në të gjitha rastet e parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe në ligjin nr.126/2020 “Për metrologjinë” në asnjë rast, si në praktikën ndërkombëtare më të mira, një institucion i cili kryen inspekte, nuk kryen inspekte mbi trupat e autorizuara dhe nuk merr asnjë masë ndaj tyre. I vetmi institucion i cili kontrollon dhe inspekton trupën e autorizuar është Autoriteti Kontraktues MFE i cili ngre të gjithë strukturat teknike të nevojshme për monitorimin dhe kontrollin e trupës (koncesionarin). Autoriteti ka të gjitha instrumentet e nevojshëm për të kontrolluar nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, e cila ka akredituar koncesionarin, për të kryer shërbimin e verifikimit metrologjik. Autoriteti Kontraktues duke urdhëruar DPA-në mund t'i kërkojë verifikim të të gjithë procedurave, mund të marrë ekspert të jashtëm për të vlerësuar punën dhe rezultatet nga ana e tij.

II. Gjatë shqyrtimit të çështjeve të ngritura në dekretin e Presidentit, në mbledhjen e Komisionit u parashtruan nga relatori Z. Ilir Beqaj argumentet dhe vlerësimet e mëposhtme:

Në lidhje me çështjet e ngritura në dekretin e Presidentit, relatori, sqaroi se çështja më e diskutueshme është autorizimi që jep drejtori përkatës, sipas kriterëve dhe rregullave që përcakton udhëzimi i ministrit. Që nga viti 2010, janë dhënë autorizime subjekteve private për të verifikuar ligjshmërinë e matjes së matësve të energjisë elektrike. Fillimisht janë dhënë 2 dhe më vonë janë bërë 4. Këto janë autorizime të lëshon drejtori i DPM-s me afat 3-vjeçar, sipas kriterëve që ka përcaktuar kuadri normues, me të cilin ai institucion funksionon. Pra ka 10 vjet që në bashkëjetim në mënyrë normale me autorizime që sot Presidenti i quan antikushtetuese dhe korruptive.

Autorizimi nuk është një shpikje e këtij ligji, jo vetëm që funksionon me ligjin e vitit 2008 të Metrologjisë, por bazohet në radhë të parë te Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë. Pra në nenin 3, pika 1, germa “a”, ku thuhet: “Akti administrativ individual, është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete”. Sigurisht për nga hierarkia ligjore KPA-ja prevalon mbi çdo ligj me shumicë të thjeshtë, ku ne e kemi përkufizuar autorizimin tek neni i përkufizimeve. Pra praktikisht autorizimi në rastin konkret është shprehje e vullnetit të DPM-së si institucion, në cilësinë e organit publik, në ushtrim të funksioneve të saja publike, në marrëdhënie me një apo me shumë subjekte të përcaktuara të së drejtës, pra mund të jenë persona juridik ose fizik privat të autorizuar, të cilët krijojnë një marrëdhënie juridike mes DPM-së, siç do ta përcaktojë autorizimi përkatës.

Edhe pika 6 e nenit 3 të KPA-së parashikon që: *Organi publik është organi i pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative. Çdo organ i enteve publike në masën që ata kryejnë funksione administrative, çdo organ i pushtetit vendor që kryen funksione administrative, çdo organ i FA, për aq kohë sa kryen funksione administrative, si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, me akt nënligjor apo me çdo lloj forme tjetër të parashikuar në legjislacionit në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative publike.* Pra, është KPA-ja që e ka njohur të drejtën që një funksion të së drejtës publike ta ushtrojë një person juridik ose fizik, ia jep ligji, akti nënligjor apo çdo lloj forme tjetër që jep ligji, siç është edhe autorizimi.

Kjo gjë materializohet edhe sot. Nëse shohim urdhërin nr.7025, datë 24.08.2017, që ka nxjerrë ministri përgjegjës i asaj kohe, i cili thotë: “Për miratimin e rregullores për autorizimin e personave juridikë për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore dhe për autorizimin e personave juridikë dhe fizikë për kryerjen e shërbimit të riparimit të dokumenteve matës”. Pra, prej 3 vjetësh ne kështu po funksionojmë, autorizime që i nxjerr DPM-ja, bazuar në rregulloren e miratuar me urdhër të një ministri. Rregullorja ka kriteret dhe procedurat e nxjerrjes së aktit të autorizimit, monitorimin dhe mbikëqyrjen e personave juridikë dhe fizikë të autorizuar nga DPM-ja, detyrimin e personave fizikë dhe juridikë të autorizuar nga DPM-ja për të zbatuar parashikimet e akteve ligjore apo nënligjore e të tjera. Edhe tarifatat, që i duhen paguar DPM-së, arkëtohen nga shërbimet përkatëse, rastet e evokimit, anulimit apo masat ndëshkuese që ka institucioni që ka marrë autorizimin dhe nuk i respekton siç duhet.

Pra, edhe sot që ne flasim, referuar Kodit të Procedurave Administrative, autorizimi i drejtorit sot ka qenë, është dhe do të ngelet një akt administrativ në pajtueshmëri të plotë me kuadrin rregullator në fuqi.

Edhe vetë ligji nr.90/2012, të cilit vetë Presidenti i referohet në shpjegimin e tij, neni 26, në pikën 4, thotë: “Mundësinë e delegimit të shërbimit, kur ai është i justifikuar ekonomikisht”. Praktikisht, po ta shikojmë me vemendje, vlerat e tarifave që personat juridikë privatë duhet të paguajnë në DPM për kryerjen e shërbimit janë të përcaktuara në kuadrin rregullator nënligjor të zbatueshëm, nuk dëmtojnë cilësinë e shërbimit publik, gjithashtu, vlerat e tarifave që personat juridikë duhet të arkëtojnë nga subjektet, që shërbimi publik është i detyruar të kryejë, janë të përcaktuara në kuadrin nënligjor të zbtueshëm.

Relatori i caktuar për shqyrtimin e dekretit, Z. Beqaj, sqaroi se nuk pajtohet me konstatimin e dekretit sipas të cilit mënyra si është formuluar ligji ia mbyll kujtudo të drejtën e ankimit në gjykatë, qoftë për rivendosje të të drejtave të cenuara, qoftë për të kërkuar dëmshpërblimet përkatëse, sepse këto janë të drejta aq themelore, sa nuk mund të kufizohen në legjislacionin për metrologjinë.

Arsyetimi që ligji anashkalon kuadrin rregullator të PPP-ve, rezulton të jetë e sforcuar, sepse vetë ligji thotë: *“me përjashtim të rasteve kur shërbimet-objekt i ligjit u janë dhënë personave juridikë privatë në një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi.”* Kjo pjesë e fjalisë gjendet e përsëritur në nene të ndryshme, pikërisht në përpjekje për të saktësuar të gjitha rastet kur kjo gjë është rezultat i një kontrate me partneritetin publik privat.

Lidhur me pretendimin e ngritur në dekret, se kontrolli i hidrokarbureve do të bëhet vetëm me një subjekt, kjo nuk presupozon se automatikisht kontrata konkrete e PPP-së mbetet në fuqi në mënyrë të përjetshme. Ajo kontratë ka një afat, që mund të jetë X vite. Fakti që në ligj kemi thënë se kemi vetëm një subjekt, nuk do të thotë se do ta gëzojë në mënyrë të përjetshme subjekti që e gëzon sot, në bazë të një kontrate që ka lidhur.

Hyrja në vlerësime teknike të regjimit automatik të rritjes së frekuencës, të gjurmueshmërisë, të inspektimit, kalojnë përtej konstatimit të faktit nëse ky ligj është kushtetues apo jo.

IV. DISKUTIME NË KOMISION

Përveç, sqarimit të pretendimeve të paraqitura në dekretin 11811, deputetët kërkuan sqarime nga Znj. Denaj edhe në lidhje me rezervat e paraqitura pas përfundimit të shqyrtimit të projektligjit “Për metrologjinë” në lidhje me dy amendamente të bëra nga Komisioni dhe konkretisht atë për vendosjen e një afati përfundimtar për importimin dhe vendosjen në treg të matësve që nuk janë *smart*, si dhe për amendimin e nenit 22 ku parashikohet shtim i periodicitetit të verifikimit fillestar në varësi të analizës së riskut dhe problematikave të tregut, por në çdo rast jo më pak se 5%.

I. Në lidhje me shqetësimet e mësipërme, Znj. Denaj sqaroi Komisionin se:

1. Në fokus gjatë hartimit të ligjit kemi pasur objektivin kryesor të fushës së metrologjisë, që është saktësia e matjes dhe jo transmetimi i të dhënave. Nevoja për të parashikuar instrumente *smart*, që është një terminologji shumë e përgjithshme, duke siguruar që këto dy elemente ndahen, shkojmë përtej dhe e pranojmë situatën nëse këto dy elementë, pra matja e vëllimit dhe pjesa e fiskalizimit, nuk interferojnë në rolet dhe përgjegjësitë e fushave të metrologjisë dhe të transmetimit të të dhënave. Duke qenë një term shumë i përgjithshëm, e bën të vështirë saktësimin si për ministrinë përgjegjëse ashtu edhe për operatorin në treg.

2. Në lidhje me pikën e dytë, rëndësia që lidhet me kostot, për sa kohë sot diskutimi dhe veprimtaria që ndodh realizohet me një kosto të menaxhuar për çdo operator, dhe kjo përcaktohet me një udhëzim të ministrit, i cili përcakton frekuencën, por edhe koston. Në rastin e koncensionarit është përsëri ministri i përgjegjës dhe Këshilli i Ministrave që do të vendosin.

Është e rëndësishme që frekuenca e monitorimeve edhe për arsye të riskut të mos lidhet me kostot shtesë për biznesin. Nëse kjo frekuencë për arsye të riskut do të ekzistojë, atëherë në udhëzimin e veçantë të ministrit përgjegjës për atë linjë të përcaktohen rregulla të cilat përcaktojnë ose që kostoja të jetë zero në udhëzim, ose të vendosen masa më të ashpra dhe më të rrepta për të përcaktuar ata operatorë, të cilët shkelin ligjin në rastin konkret. Pra, nëse instrumentet *smart* bëjnë këtë diferencën ndërmjet vëllimit dhe fiskalizimit, kjo është shumë e rëndësishme për ne që të jetë e qartë dhe, e dyta, kostot shtesë duhet të jenë sa më të reduktuara dhe sa më transparente për operatorët.

Znj. Denaj u shpreh se, nëse kjo e dyta përcaktohet me një udhëzim të ministrit përgjegjës, ne jemi dakord të shkojmë përpara, sikurse edhe komisioni e ka përcaktuar dhe biem dakord me propozimet tuaja.

Edhe Z. Edmond Ahmeti, Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve, në lidhje me këtë shqetësim, mbështeti edhe njëherë qëndrimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë duke sqaruar se është udhëzimi i ministrit përgjegjës ai i cili përcakton tarifatat dhe zotimi i ministrisë është që për asnjë rast nuk do ngarkohen me kosto shtesë dhe me detyrime të tjera subjektet që operojnë në një treg të caktuar.

II. Relatori i çështjes, Z. Beqaj u shpreh gjithashtu në lidhje me këto dy amendime.

Në lidhje me dy amendimet e neneve 18 dhe 22, të cilat janë iniciuar nga ai vetë në komision, relatori sqaroi se *smart meter* është një përkufizim i ri, por kjo nuk do të thotë që duhet të jemi refraktar ndaj gjërave të reja. Qenia instrument *smart* nuk lidhet me fiskalizimin. Çdo matës ekziston në momentin që lexohet procesi matës që bën. Shqipëria nuk ka pse të mos jetë ambicioze e të thotë që nga janari 2023 do të importojë vetëm instrumenta matëse *smart*. Matësi

ekzistues mund të bashkëjetojë me matësin *smart* deri në vitin 2028. Nëse një moment të caktuar mundet që për nivelin ekonomik të vendit, kjo lloj matjeje të jetë e kushteshme, në ligj i kemi dhënë të drejtë Këshillit të Ministrave të bëjë përjashtimet e saj, por vendet e zhvilluara i kanë shpikur dhe po i përdorin gjerësisht *smart meters* jo për të rritur kostot, por për t'i ulur ato.

Lidhur me shtimin e frekuencës, projektligji parashikonte që, në bazë të analizës së vlerësimit të riskut, të shtoheshin verifikimet. Propozimi i miratuar në komision që marzhi i gabimit të lejohet pa shifër frekuence deri në 5% të asaj që konstatohet ka pasur ndjesi të lartë, sepse kjo, duke sjellë më shumë kontrolle, do të rrisë koston që do të paguajë shpërndarësi i karburantit, i cili do të rëndojë konsumatorin. Në radhë të parë, duhet të nisemi nga interesi i konsumatorëve. Verifikimin e sasisë së matjes e duam pikërisht për konsumatorin. Nëse një subjekt do të jetë me gabime jo më shumë se 5%, nuk i rritet frekuenca e kontrollit.

Tarifat e matjeve kanë qenë, janë dhe do të mbeten përgjegjësi e ministrit përgjegjës. Ka një ligj për tarifin në Shqipëri, ka një metodologji se si përcaktohen të gjitha tarifin. Të gjitha bizneset që shpërndajnë karburant dhe gaz, nëse duan të kontrollohen jo më shumë se 2 herë, le t'i mbajnë aparaturnat e tyre të sakta dhe nga vlerësimi i riskut të kenë shmangie jo më shumë se 5%.

Gjithashtu, relatori u shpreh se gjuha e përdorur në dekretin e presidentit është një gjuhë e rëndë, ku akuzohen deputetët për korrupsion parlamentar. Elementi kryesor për të cilin kthehet ky ligj është autorizimi i subjekteve private për të kryer shërbime të verifikimit dhe riparimit në fushën e metrologjisë, dhe ky sektor ka që në vitin 2008 që operon me autorizime, pra nuk është risi e këtij ligji të ri për metrologjinë. Presidenti duhet të ishte më koherent në qëndrimet e tij pasi ka qenë deputet kur ky ligj është votuar në vitin 2008, si dhe në funksionet e zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Industrisë, Tregtisë dhe Energjetikës në periudhën shtator 2010- janar 2011, dhe si ministër përgjegjës për çështjet e metrologjisë, nuk ka ndërmarrë asnjë nismë ligjore për të ndryshuar ligjin nr. 9875, edhe pse kishte të njëjtët elementë të cilat parashikohen edhe tek ligji i ri dhe tashmë konsiderohen si antikushtetues.

V. PËRFUNDIME

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm vendosi rrëzimin e Dekretit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë nr. 11811, datë 5.11.2020 "Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 126/2020 "Për metrologjinë".

Ilir BEQAJ

Relator

Niko PELESHI

Kryetar